



UNIVERSITETI BARLETI



UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANE

UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANE

Nr. 1379 Prot, datë 26.11.2021

Nr. 3103 Prot, datë 26.11.2021

**MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI**

**NDËRMJET**

**UNIVERSITETIT "BARLETI"**

**DHE**

**UNIVERSITETIT TË MJEKËSISË, TIRANË**

**Universiteti Barleti**, me seli në adresën Rruga "Fran Bardhi" Tiranë, i përfaqësuar nga Rektori, Prof. Dr. Suzana Guxholli (në vijim referuar si "**UniBa**)

dhe

**Universitetit i Mjekësisë, Tiranë**, me seli në adresën Rruga e "Dibrës" Nr. 371 Tiranë, i përfaqësuar nga Rektori, Prof. Dr. Arben Gjata (në vijim referuar si "**UMT**

Referuar këtu më poshtë individualisht si "**Pala**" dhe bashkërisht si "**Palët**",

në zbatim të kompetencave të tyre përkatëse, bien dakord të bashkëpunojnë për nxitjen e shkëmbimit dhe bashkëpunimin e shumëanshëm në funksion të zhvillimit institucional midis dy institucioneve të arsimit të lartë.

## Neni 1

Bashkëpunimi ndërmjet të dy Universiteteve do të përfshijë:

- Shkëmbimin e pedagogëve dhe kërkuesve shkencorë në kuadrin e veprimtarisë së mësimdhënies, hulumtimit dhe kërkimit shkencor;
- Shkëmbimin e studentëve në tri ciklet e studimit: Bachelor, Master, Specializim dhe Doktoratë;
- Nxitjen, mbështetjen dhe realizimin e projekteve të përbashkëta;
- Nxitjen, mbështetjen dhe realizimin e veprimtarive të tjera shkencore (konferenca, seminare e botime në fusha me interes të dyanshëm);
- Shkëmbimin e literaturës shkencore;
- Shkëmbimin e përvojës lidhur me menaxhimin institucional.

## Neni 2

Të dy Universitetet bien dakord që realizimi i veprimtarive të mësipërme të kryhet në varësi të burimeve dhe potencialit të disponueshme nga secili institucion.

Detajimi i bashkëpunimit në fushat e mësipërme (1/a-f) dhe ndjekja e zbatimit të Marrëveshjes, do të realizohet nga i ngarkuari i Rektorit nga secili Universitet.

## Neni 3

Çdo nen i kësaj marrëveshje mund të ndryshohet, të amendohet ose të revokohet në çdo kohë pas një konsultimi dhe mirëkuptimi reciprok ndërmjet të dy Universiteteve.

## Neni 4

Kjo Marrëveshje hyn në fuqi në datën e nënshkrimit të saj nga të dy Palët dhe është e vlefshme deri me datë 26.11.2025. Kjo marrëveshje rinovohet automatikisht në mënyrë të heshtur, me të njëjtën kohëzgjatje (4 vjeçare).

Marrëveshje mund të zgjidhet para përfundimit të afatit të mësipërm me dakordësinë e përbashkët të Palëve ose nga secila Palë nëpërmjet një njoftimi me shkrim drejtuar Palës tjetër të paktën 90 (nëntëdhjetë) ditë përpara datës së zgjidhjes.

Kjo Marrëveshje hartohet në 4 (katër) kopje, në gjuhën Shqipe, tekstet e saj janë autentike. Pasi lexohet, firmosen nga Rektorët përkatës.

REKTORI  
UNIVERSITETI "BARLETTI"  
PROF. DR SUZANA GUXHOLLI



REKTORI  
UNIVERSITETI I MJEKËSISË  
PROF. DR. ARBEN GJATA

